



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE**

**VENDIM**

***Nr. 113 Datë 31.07.2012***

**PËR**  
**FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR RISHIKIMIN E RREGULLAVE TË**  
**ALOKIMIT TË KAPACITETEVE TË INTERKONJEKSIONIT**  
**MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE NR. 13,**  
**DATË 22.02.2011**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, gërma ç, paragrafi “ii”, dhe 9, të Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar,”, pikës 7, gërma “b”, të Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike të miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 338, datë 19.3.2008, të ndryshuar, si dhe Kapitullit X, të Rregullave të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike të miratuara nga ERE me Vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 68, datë 23.6.2008, Bordi i Komisionerëve të ERE-s në mbledhjen e tij të datës 31.07.2012, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut, ne lidhje me nisjen e procesit të rishikimit të Rregullave të alokimit të kapaciteteve të interkonjeksioneve

**Vendosi:**

1. Fillimin e procedurave për rishikimin e Rregullave të Alokimit të Kapaciteteve të Interkonjeksionit miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 13, datë 22.02.2011.
2. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqërinë OST sh.a, për vendimin e Bordit të Komisionerëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Sokol RAMADANI**